



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 27.4.2023

Nr: 417

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË AGJENCISË NDËRKOMBËTARE TË LAJMEVE "ASSOCIATED PRESS", SHOQËRISË "LAST NEWS MEDIA NETWORK", TELEVISIONIT "TV1 CHANNEL", "ABC NEWS", "LIGHT STUDIO AGENCY" DHE "MCN TV", PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 27.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

- KËRKUES:** Agjencia Ndërkombëtare e Lajmeve "Associated Press", me adresë Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati 16, Tiranë dhe me përfaqësues z. Lllazar Semini;
- Shoqëria "Last News Media Network", me seli në Tiranë dhe me përfaqësues z. Marjon Gorica;
- Televizioni "TV1-CHANNEL", me adresë Lagjja "Qemal Stafa Shkodër" dhe me përfaqësues z. Edmond Ndou;
- Televizioni "ABC NEWS", me adresë Rr. "Aleksandër Moisiu", Tiranë dhe me përfaqësues z. Sokol Balla;
- "Light Studio Agency" me adresë në Tiranë dhe me përfaqësues z. Gent Shkullaku;
- Televizioni "MCN TV" me adresë TEG, Lundër, Tiranë dhe me përfaqësuese znj. Marsida Karabollaj.
- OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
- BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, i

Data: 27.4.2023 Nr: 417  
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve "Associated Press", Shoqërisë "Last News Media Network", Televizionit "Tv1 Channel", "Abc News", "Light Studio Agency" dhe "Mcn Tv", për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

## V Ë R E J:

Agjencia Ndërkombëtare e Lajmeve “Associated Press” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 6 (gjashtë) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Agjencia Ndërkombëtare e Lajmeve “Associated Press” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë gazetarë në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Shoqëria “Last News Media Network” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 3 (tre) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Shoqëria “Last News Media Network” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë gazetarë në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Televizioni TV1-CHANNEL i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 21 (njëzetë e një) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni TV1-CHANNEL është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë gazetarë në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “ABC NEWS” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 75 (shtatëdhjetë e pesë) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “ABC NEWS” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë gazetarë në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

“Light Studio Agency” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 6 (gjashtë) fotografë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “Light Studio Agency” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë gazetarë në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Televizioni “MCN TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 31 (tridhjetë e një) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “MCN TV” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë gazetarë në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Data: 27.4.2023 Nr: 417  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press”, Shoqërisë “Last News Media Network”, Televizionit “Tv1 Channel”, “Abc News”, “Light Studio Agency” dhe “Mcn Tv”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S :

1. Akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 3 (tre) gazetarëve të shoqërisë “Last News Media Network”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 21 (njëzetë e një) gazetarëve të Televizionit TV1-CHANNEL, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 75 (shtatëdhjetë e pesë) gazetarëve të Televizionit “ABC NEWS”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin e 6 (gjashtë) fotografëve të “Light Studio Agency”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Akreditimin e 31 (tridhjetë e një) gazetarëve të Televizionit “MCN TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 27.4.2023 Nr: 417  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press”, Shoqërisë “Last News Media Network”, Televizionit “Tv1 Channel”, “Abc News”, “Light Studio Agency” dhe “Mcn Tv”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.